



**Misionit të OSBE-së në Kosovë i është besuar roli udhëheqës për çështjet që kanë të bëjnë me ndërtim institucional dhe të demokracisë, me shtet ligjor dhe me të drejta të njeriut në rajon. Misioni e formon kështu një komponentë të veçantë apo "degë" të Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), dhe ndër të tjera është përgjegjëse edhe për trajnimin e administratorëve të policisë, civil dhe ata të drejtësisë; vazhdimin e zhvillimit të shoqërisë civile; përkrahjen e zhvillimit të mediave; organizimin dhe mbikqyrjen e zgjedhjeve; dhe mbikqyrjen, mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të njeriut.**

ORGANIZATA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË

# Misioni në Kosovë

## DUKE PËRKRAHUR DEMOKRACINË NË KOSOVË

### Hyrje

Ndërtimi i institucioneve nënkupton zhvillimin e strukturave demokratike që prezantojnë shoqërinë dhe punojnë në emër të shoqërisë. OSBE-ja, shtylla e ndërtimit të Institucioneve të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë ka punuar me tre "institucionet" kryesore të shoqërisë, qeverinë, jetën politike dhe jetën publike që të ngrisin kuadrot e tyre (ndërtojnë kapacitetet) për të punuar në mënyrë të hapur, transparente dhe të kenë përgjegjësi ndaj publikut.

Pas zgjedhjeve të nëntorit 2001 të Kuvendit të Kosovës, OSBE-ja është përqëndruar në ngritjen e kuadrove dhe bashkëveprimin e institucioneve, që është esenciale për përmirësimin e nevojave të njerëzve në proceset politike dhe në të gjitha nivelet e vetëqeverisjes. Vëmendje e posaçme i është kushtuar përfshirjes së grupeve të marginalizuara si ato të femrave dhe komuniteteve të vogla për të avansuar pjesëmarrjen e tyre në institucionet e shoqërisë.

OSBE-ja ka hartuar një seri të profileve që kanë informacione për partitë politike, OJQ-të dhe strukturat administrative civile që operojnë në komunë. Ato mund ti gjeni në website-in e OSBE-së [www.osce.org/kosovo/](http://www.osce.org/kosovo/)

### Institucionet e qeverisë

Krijimi i institucioneve demokratike në Kosovë janë në fazë të hershme. Pas dy zgjedhjeve të sukseshme në vitin 2000 dhe 2001, strukturat demokratike të orientuara ende janë duke lëshuar rrënjë në nivelin komunal dhe demokratik. Përkrahja e OSBE-së ndaj ngritjes së kuadrove përqëndrohet kryesisht në këshillat dhe ndihmën e dhënë për t'u përcjellur zyrtarëve të qeverisë të të gjitha niveleve përvojat më të mira demokratike që të avansojnë konceptin e qeverisjes së mirëfilltë në punën e tyre të përditshme.

### Iniciativa për mbështetjen e Kuvendit

Programe të trajnimeve të specializuara janë duke iu mundësuar dhe vazhdojnë t'iu mundësojnë institucioneve që të zhvillohen vetë, gjë që është më se e rëndësishme për vetëqeverisjen demokratike dhe me përgjegjësi. Në vitin 2001, përqëndrimi kryesor ishin Kuvendet e zgjedhura komunale e tani Kuvendi i Kosovës, anëtarët dhe përgjegjësitë e saj.

Si përgjigje ndaj shumë sfidave me të cilën është ballafaquar Kuvendi i Kosovës, është themeluar një program për të mbështetur atë, program ky i shumë agjensive, Iniciativa Përkrahëse e Kuvendit (IPK), me qëllim që të nxis një punë më efikase parlamentare duke u përqëndruar në zhvillimin e një legjislature efektive dhe përfaqësuese. Qëllimi kryesor është që të sigurohet përkrahje në themelimin e strukturave të përkohshme të vetëqeverisjes duke vënë theksin në transparencë, udhëheqje morale dhe qeverisje demokratike.

Program gjithëpërfshirës i trajnimit do t'iu mundësojë institucioneve vetëqeverisëse që të luajnë një rol konstruktiv në jetën politike dhe publike. IPK-ja iu ndihmon deputetëve që të zhvillojnë aftësi dhe të fitojnë përvojë në rolet e tyre, në lëmitë si: transparencë, etika dhe shqyrtimi legjislativ, përgatitjet e buxhetit, trajnimi i mediave, puna e këshillave, lidhjet në mes të kuvendit dhe komunës, shërbimet rajonale dhe të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Ekspertët parlamentarë dhe këshilltarët janë ftuar që të marrin pjesë në trajnime dhe seminare që të shkëmbejnë përvojën dhe aftësitë e tyre.



**Për informata të tjera, kontaktoni me**

**Zyrën për informim publik të OSBE-së, Prishtinë**

**Zyra e shtypit: +381 38 500 162 ext. 260**

**Zyra e informimit publik: +381 38 500 162 ext. 145**

**Fax: +381 38 500 188 E-mail: [press@omik.org](mailto:press@omik.org)**

**Website: [www.osce.org/kosovo](http://www.osce.org/kosovo)**

## Instituti i administrimit civil

Personat civil luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e strukturave efikase dhe demokratike në Kosovë. Instituti i Administrimit Civil (IAC) është themeluar nga OSBE-ja në shkurt të vitit 2000 me një qëllim afatgjatë të mbrojtjes së sektorëve publik profesional dhe të pavarur të bazuar në ligjin e rendin (sundimin e ligjit), shërbimet e orientuara nga konsumatorët dhe menaxhimi efikas.

Vitin e kaluar, nevojë prioritare ka qenë sigurimi i zyrtarëve komunal Kryetarin e Kuvendit Komunal dhe zyrtarët kryesorë ekzekutiv si dhe të tjerët në administrim, trajnimet mbi rolet dhe përgjegjësitë e tyre përbrenda strukturave qeverisëse. Një punë e tillë në ngritjen e kuadrove ka për qëllim përmirësimin e marrëdhënieve në mes të organeve komunale në proceset administrative dhe vendim marrëse duke përfshirë edhe nevojën e planifikimit afatgjatë komunal.

Puna e IAC-së do të transferohet vazhdimisht në Institucionet e Kosovës të Administrimit Publik (IKAP) që të forcohen funksionet e qeverisë dhe të avansohet përgjegjësia e vendorëve.

## Institucionet e jetës politike

Ekzistimi i një spektri të gjerë të partive politike që veprojnë në krijimin e një klime të shëndoshë politike është esenciale në çdo demokraci. OSBE-ja ka për qëllim që të zhvilloj parti të afta, të pavarura e demokratike që dijnë të promovojnë veten. Forcimi i kapacitetit organizativ varet nga përgjegjësia e partive që të modernizojnë fushatën e tyre dhe përvojën qeveritare, strukturat dhe standardet si dhe formulimin e parimeve.

## Programet e partive politike dhe ato gjinore

Në vitin 2002, përqëndrohemi në përmbajtjen e parimeve me të cilat partitë duhet të ballafaqohen dhe të zhvillohen, duke përfshirë këtu edhe brengat e njerëzve, votuesve, një kontribut i tillë mund të jetë një mjet i rëndësishëm në suksesin e elektoratit në të ardhmen. Programet e trajnimeve mbahen për të ngritur kuadrot e partive politike që të shtohet funksioni i tyre në një shoqëri demokratike.

OSBE-ja poashtu do të vazhdoj që të mbaj Forumet Konsultative të Partive Politike (FKPP), një mekanizëm ky përmes së cilit partitë politike mund të përfshihen në dialog me të tjerët dhe komunitetin ndërkombëtar.

Femrat poashtu luajnë rol të rëndësishëm në të gjitha aspektet e shoqërisë dhe me një forcim të tyre dhe pjesëmarrje të plotë ato mund të kontribuojnë në zgjidhjet e vazhdueshme të tranzicionit të Kosovës në një shoqëri demokratike. Deri më tani, OSBE-ja ka punuar që të mbroj pjesëmarrjen e femrave në të gjithë sektorët e shoqërisë që të forcoj kontributin e tyre si vendim marrëse në jetën publike dhe atë politike. Theks i veçantë është vënë në forcimin e pozitës së femrave prezente në qeveri dhe mbajtjen e trajnimeve aftësuese për kandidatët e ardhshëm.

## Edukimi civil dhe pjesëmarrja

Një nga elementet kryesore të demokracisë së mirëfilltë është të dëgjuarit dhe të veprosht në bazë të zërave të elektoratit. Një mori projektesh mbahen nga OSBE-ja që të përkrahin zhvillimin e strukturave demokratike përmes "bashkëveprimit institucional" dhe duke inkurajuar qytetarët që të mbrojnë brengat e tyre legjitime dhe të kërkojnë përgjegjësi për veprimet e personave të zgjedhur nga ata.

Programi i qeverisjes së përgjegjshme dhe pjesëmarrjes civile (QPPC)

ofron trajnime praktike institucioneve komunale, deputetëve të Kuvendit, administrimit civil dhe shoqërisë civile për përgjegjësitë e qeverisë ndaj publikut si dhe pjesëmarrjen aktive të akterëve joqeveritarë që të ndikojnë në përgjegjësinë e qeverisë për brengat e tyre ditore. Akademia e OSBE-së e Shoqërisë Civile ka për qëllim që të zhvilloj OJQ-të e afta duke u mundësuar atyre që të punojnë dhe bashkëveprojnë me publikun dhe vendim marrësit në formulimin dhe realizimin e parimeve. "Komuna juaj – e drejta juaj" është program që thekson vetëdijen e qytetarëve dhe pjesëmarrjen e tyre në strukturat komunale dhe ato qendrore qeverisëse.

## Institucionet e jetës publike

Shoqëria civile luan një rol të rëndësishëm dhe me ndikim që zërat që shprehin interesat dhe brengat e qytetarëve të jenë të zëshëm e të dëgjohen në qeveri. OSBE-ja është duke ndihmuar që të ngriten kuadrot e OJQ-ve dhe grupeve civile që të marrin pjesë në procesin demokratik. Vëmendje e posaçme i është kushtuar mënyrës se si mund të punojë në mënyrë efektive shoqëria civile si një partner kritik dhe përkrahës për institucionet e Qeverisë në Kosovë. Zëri i tyre do të promovoj demokracinë dhe qeverisjen e mirëfilltë në lëmitë si themelimi i parimeve publike dhe realizimi i tyre përmes procesit të dialogut dhe bashkëveprimit me institucionet e tjera.

## Organizatave joqeveritare

OSBE-ja ka bashkëpunuar me Fondacionin Kosovar të Shoqërisë së Hapur (FKSHH) që të grumbulloj gjithë komunitetin e OJQ-ve për të identifikuar së bashku mënyrat për të ngritur zërin e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile. Qëllimi kryesor është që të ngriten kuadrot e të luajnë një rol më të madh e më aktiv në zhvillimin e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Akterëve të shoqërisë civile u jepen këshilla për mundësitë e themelimit të një bordi këshillues për OJQ-të si një mjet për të realizuar marrëdhënie efektive me strukturat qeverisëse.

Një rrjet i OJQ-ve dhe qendrave të shoqërisë civile të OSBE-së në rajon është prioritet për zhvillimet në mes të komuniteteve dhe ato ndër rajonale në aktivitetet e shoqërisë civile. Kjo shpie kah një dialog më i madh dhe një bashkëveprim që do të ndihmoj në shtimin e rolit të OJQ-ve të komuniteteve në zhvillimin e mëtejshëm të qeverisjes së mirëfilltë në Evropën juglindore

## Interesat e vogla dhe të mëdha të komuniteteve

OSBE-ja vazhdon të vë theks të veçantë në ngritjen e vetëdijes lidhur me brengat e komuniteteve më të vogla të Kosovës. Mjetet e ndërtimit të sigurisë që kanë për qëllim rritjen e pjesëmarrjes së komuniteteve më të vogla në shoqëri kanë qenë dhe do të vihen në vend.

OSBE-ja ka ngritur disa qendra të komuniteteve tek komunitetet e vogla me qëllim që të krijohet dhe mbështeten kushtet për një përfshirje më të madhe të qytetarëve në procesin vendimmarrës. Qendrat në fjalë shërbejnë si vendtakime informuese për zhvillimet e mëdha përbrenda komunitetit. Ato janë edhe vend i trajnimeve dhe për të ndihmuar iniciativat e komuniteteve dhe të ndihmojnë në zhvillimet demokratike.

Përpjekje të veçanta janë bërë për të përmirësuar përfaqësimin e komuniteteve të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve që të dëgjohen edhe brengat e tyre. Tradicionalisht ata nuk janë përfshirë në strukturat kryesore politike dhe sociale dhe janë ndarë në tërë Kosovën duke mbetur mjaft të rrezikuar.

